

**AL-MEXWOOD sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare**  
**për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2017**  
(dhe raporti i Audituesit të Pavarur bashkëlidhur)

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për: Drejtimin e shoqërisë  
"AL-MEXWOOD" SH.P.K.  
Cekin  
Gramsh

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare "AL-MEXWOOD" SH.P.K. (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur me datën 31 Dhjetor 2017, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë tregtare "AL-MEXWOOD" SH.P.K. , me datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) që zbatohen në Shqipëri.

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Organeve të Qeverisjes për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) që zbatohen në Shqipëri dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Drejtimi ka gjithashtu, përgjegjësinë për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar veprimtaritë në vijimësi, duke dhënë për këtë qëllim, kur është rasti, informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë nisur nga parimi kontabël i vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likujdojë shoqërinë, të ndërpresë aktivitetet e saj, ose rasteve kur drejtimi nuk ka alternativë tjetër reale përveç likuidimit të shoqërisë.

Organet e ngarkuara me qeverisjen kanë përgjegjësinë për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

#### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona të auditimit janë: të arrijmë një siguri të arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfshin opinionin e audituesit. Siguria e arsyeshme megjithëse është një siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kërkon që ne si auditues të ushtrojmë gjykimin profesional dhe të ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomali të materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i anomali të materiale si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Kur arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Crowe AL shpk

Nexhmije Celo, (AL/CPA)  
Partner Auditimi  
Rr. Brigada 8, Tirana Albania  
17 Maj 2018



**BILANCI KONTABEL ME DATE 31.12.2017**

	AKTIVET	Shenime	Viti ushtrimor 2017	Viti i mëparshëm 2016
<b>I</b>	<b>AKTIVET AFATSHKURTRA</b>		<b>196,568,197</b>	<b>156,525,845</b>
1	<b>Mjetet monetare</b>		<b>37,542,259</b>	<b>40,649,239</b>
a)	Mjete monetare ne Arke		17,698,883	31,808,017
b)	Mjete monetare ne Banke		19,843,376	8,841,222
c)	Letra me vlere afatshkurtra		-	-
2	<b>Derivativë dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim</b>			
a)	Derivatevet			
b)	Aktivet e mbajtura per tregtim			
3	<b>Aktive te tjera financiare afatshkurtra</b>		<b>126,331,396</b>	<b>104,084,827</b>
a)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme(kliente)		61,702,414	41,394,609
b)	Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme(TVSH)		3,932,420	980,582
c)	Llogari kerkesa te tjera te arketsuhme Tatim mbi fitimin			912,662
d)	Debitor, kreditor te tjere( ngurtesimi)		15,711,682	
e)	Debitore ( mredhenie me ortaket )		44,984,880	60,796,974
4.	<b>Inventari</b>		<b>32,694,542</b>	<b>11,791,779</b>
a)	Lëndët e para emateriale ndihmese		28,588,574	11,233,426
b)	Prodhim në proces			
c)	Produkte të gatshme			
d)	Mallra për rishitje			
e)	Parapagesat për furnizime		4,105,968	558,353
f)	Te tjera gjendje iventari ne magazine		-	-
g)	Te tjera gjendje iventari ne perdorim		-	-
5.	<b>Aktivet biologjike afatshkurtëra</b>			
6.	<b>Aktivet afatshkurtëra të mbajtura për shitje</b>			
7.	<b>Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra</b> Shpenzime te periudhave te ardheshme			
<b>II</b>	<b>AKTIVET AFATGJATA</b>		<b>51,378,863</b>	<b>54,038,982</b>
1.	<b>Investimet financiare afatgjata</b>			
a)	Aksione e pjesëmarrje tjera në njësi te kontrolluara(vetëm në PF të pakonsoliduara)			
b)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje			
c)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë			
d)	Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata			
2.	<b>Aktive afatgjata materiale</b>		<b>51,378,863</b>	<b>54,038,982</b>
a)	Toka		2,000,000	2,000,000
b)	Ndërtesa		33,344,666	35,099,648
c)	Makineri dhe paisje( pune)		8,344,903	10,260,506
d)	Mjete transporti		6,669,473	5,833,082
e)	Aktive afatgjata ( paisje zyre)		1,019,821	845,746
3.	<b>Aktive Biologjike afatgjata</b>			
4.	<b>Aktivet afatgjata jomateriale</b>			
a)	Emri i mirë			
b)	Shpenzimet e zhvillimit			
c)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale			
5.	<b>Kapital aksionar i papaguar</b>			
6.	<b>Aktive te tjera afatgjata (ne proces)</b>			
	<b>TOTALI I AKTIVEVE (I+II)</b>		<b>247,947,060</b>	<b>210,564,827</b>

**BILANCI KONTABEL ME DATE 31.12.2017**

	<b>PASIVET DHE KAPITALI</b>	<b>Shenime</b>	<b>Viti i ushtrimor 2017</b>	<b>Viti i mëparshëm 2016</b>
<b>I</b>	<b>PASIVET AFATSHKURTERA</b>		<b>68,387,678</b>	<b>42,448,719</b>
1	Derivativet		-	-
2	Huamarrjet		-	-
a)	<i>Huat dhe obligacionet afatshkurtra</i>		-	-
b)	<i>Kthimet / ripagesat e huave afatgjata</i>		-	-
c)	<i>Bono te konvertueshme</i>		-	-
3	Huate dhe parapagimet		<b>68,387,678</b>	<b>42,448,719</b>
a)	<i>Te pagueshme ndaj furnitoreve</i>		63,629,331	41,677,340
b)	<i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>		1,012,937	584,295
c)	<i>Detyrimet per sigurimet shoqerore e shendetesore</i>		319,172	171,934
d)	<i>Detyrime tatimore per TAP</i>		24,050	13,650
e)	<i>Detyrime tatimore per tatim fitimin</i>		714,583	
f)	<i>Detyrime tatimore per TVSH</i>			-
g)	<i>Detyrime tatimore per tatimin ne burim</i>		1,500	1,500
gj)	<i>Hua te tjera</i>			
h)	<i>Debitore dhe kreditore te tjere</i>		2,686,105	
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra			
5	Provizionet afatshkurtra			
<b>II</b>	<b>PASIVET AFATGJATA</b>		<b>7,652,562</b>	<b>13,175,839</b>
1	Huat afatgjata		<b>7,652,562</b>	<b>13,175,839</b>
a)	<i>Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare</i>		7,652,562	13,175,839
b)	<i>Bonot e konvertueshme</i>			
2	Huamarje te tjera afatgjata			
3	Grantet dhe te ardhura te shtyra (Subvencion per investime)		-	-
4	Provizione afatgjata		-	-
	<b>TOTALI I PASIVEVE (I+II)</b>		<b>76,040,240</b>	<b>55,624,558</b>
<b>III</b>	<b>KAPITALI</b>		<b>171,906,820</b>	<b>154,940,269</b>
1	Aksionet e pakices (perdoret vetem ne PF te konsoliduara)			
2	Kapitali qe i perket aksionareve te shoqerise meme (perdoret vetem ne pasqyrat financiare te konsoliduara)			
3	Kapitali aksionar		106,841,149	106,841,149
4	Primi i aksionit			
	Diferenca nga rivlersimi			
5	Njesite ose aksionet e thesarit (negative)			
6	Rezerva statusore			
7	Rezerva ligjore		10,935,031	20,935,031
8	Rezerva per investime		37,157,386	18,045,079
9	Fitimet e pashperndara		6,703	6,703
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar		16,966,551	9,112,307
11			-	-
	<b>TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT (I,II,III)</b>		<b>247,947,060</b>	<b>210,564,827</b>

## Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve per vitin 2017

(Bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas Natyres)

PERSHKRIMI I ELEMENTEVE				Viti Ushtrimor 2017	Viti meparshem 2016
	shenime				
1	701-705	<b>Shitjet neto</b>		173,117,576	71,780,066
2	702-708X	Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		311,346	4,901
3	71	Ndryshime ne inventarin e produkteve te gatshme dhe te punes ne proces		-	-
4		Puna e kryer nga njesia ekonomike raportuese dhe e kapitalizuar		-	-
5	601-608X	Mallrat, lendet e para dhe sberbimet		(133,441,901)	(36,524,100)
6		Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit( )		(1,889,847)	(1,267,437)
7	(X)	Shpenzime te personelit		(11,549,369)	(10,194,136)
		Pagat e punonjeseve		(9,966,600)	(8,821,951)
		Shpenzimet e sigurimeve shogerore		(1,582,769)	(1,372,185)
		Paga te tjera			
		Shpenzimet e shperblimit te punonjeseve (udhetime e otela)			
8	(X)	Amortizimi dhe renia ne vlera (zhvleresimi)		(5,283,255)	(6,429,046)
9	X	<b>Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit (1+2+/-3-4-5-6-7-8)</b>		21,264,550	17,370,248
10	X(X)	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara		-	-
11	X(X)	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet			
12	X(X)	<b>Te ardhurat dhe shpenzime te tjera financiare</b>		(1,273,902)	(6,584,902)
		Shpenzime te tjera (vlera e mibetur e njejt te shitur )			(2,516,074)
		Humbje nga mosarketimi (borzhi i keqe )			(1,580,323)
		Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi		(787,926)	(1,206,002)
		Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimit		(315,976)	(914,258)
		Gjaba dhe penalitete		(170,000)	(368,245)
13		<b>Totali te Ardhurave dhe Shpenzimeve Financiare (10+11+12)</b>		19,990,648	10,785,346
14	X	<b>Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)</b>		19,990,648	10,785,346
15	(X)	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		3,024,097	1,673,039
16	X	<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)</b>		16,966,551	9,112,307
	X1	Elementet e pasqyave te konsoliduara			

**PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE**  
*Sipas metodes indirekte viti 2017*

Nr	Perskrimi	Viti ushtrimor 2017		Viti paraushtrimor 2016	
	<b>Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytezimit</b>				
	Fitimi neto	X	16,966,551	X	9,112,307
	Rregullime per:				
	Amortizimin	X	<b>5,283,255</b>	X	<b>6,429,046</b>
	Fitime / Humbje nga kembimet valutore	(X)X		(X)X	
	Te ardhura nga investimet	(X)		(X)	
	Shpenzime per interesa	(X)		(X)	
	Rritje / renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme				
	nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	(X)X	(22,246,569)	(X)X	(4,036,065)
	Rritje / renie ne tepricen e inventarit	(X)X	(20,902,763)	(X)X	5,030,521
	Rritje / renie ne tepricen e detyrimeve, per tu paguar nga aktiviteti	(X)X	20,415,682	(X)X	(17,099,643)
	Parate e perftuara nga aktivitetet	X		X	
	Interesi i paguar			(X)	
	Tatimfitimi i paguar	(X)		(X)	
	<b>Paraja neto nga aktivitetet e shfrytezimit</b>		<b>(483,844)</b>	-	<b>(563,834)</b>
	<b>Fluksi i parave nga veprimtarite investuese</b>				
	Blerja e shoqerise se kontrolluar X minus parate e arketuar	(X)		(X)	
	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(X)	(2,623,136)	(X)	(495,830)
	Te ardhura nga shitja e pajisjeve	X		X	
	Interesi i arketuar	X		X	2,516,074
	Dividentet e arketuar	X		X	
	<b>Paraja neto, e perdorur ne aktivitetet investuese</b>		<b>(2,623,136)</b>	-	<b>2,020,244</b>
	<b>Fluksi i parave nga veprimtarite financiare</b>				
	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar	X		X	
	Te ardhura nga huamarrje afatgjata	X		X	
	Pagesat e detyrimeve te tjera ( gjoba )	(X)		(X)	
	Detyrime te tjera ( interesa te tjera				
	Detyrime te tjera ( te ortakut )				
	Dividentet e paguar	(X)	-	(X)	-
	<b>Paraja neto e perdorur ne aktivitetet financiare</b>		-	-	-
			-		-
	<b>Rritja / renia neto e mjeteve monetare</b>	X2-X1	<b>(3,106,980)</b>	-	<b>1,456,410</b>
	<b>Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel</b>	X1	<b>40,649,239</b>	X1	<b>39,192,829</b>
	<b>Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel</b>	X2-X1	<b>37,542,259</b>	x2-x1	<b>40,649,239</b>

**Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital Viti 2017**  
( Ne nje pasqyre te pakonsoliduar )

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva nga rivlersimi	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>I Pozicioni me 31 dhjetor 2015</b>	<b>106,841,149</b>	-	-	-	<b>20,935,031</b>	<b>18,051,782</b>	<b>145,827,962</b>
A Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel							
1 Fitimi neto per periudhen kontabel						9,112,307	9,112,307
2 Dividentet e paguar							-
3 Rritje e kapitalit nga fitimet e mbartura					18,045,079	(18,045,079)	-
4 Rritje te rrezervave te rivleresimit							-
<b>II Pozicioni me 31 dhjetor 2016</b>	<b>106,841,149</b>	-	-	-	<b>38,980,110</b>	<b>9,119,010</b>	<b>154,940,269</b>
1 Fitimi neto per periudhen kontabel						16,966,551	16,966,551
2 Dividentet e paguar							-
3 Rritje e kapitalit nga fitimet e mbartura					9,112,307	(9,112,307)	-
4 Rritje te rrezervave te rivleresimit							-
<b>III Pozicioni me 31 dhjetor 2017</b>	<b>106,841,149</b>	-	-	-	<b>48,092,417</b>	<b>16,973,254</b>	<b>171,906,820</b>